

Tiranë, më 25 Tetor 2021

**KËRKESË PËR OFERTË**  
**SUBJEKT TREGTAR PËR OFRIMIN E SALLËS ME QERA, COFFEE BREAK DHE**  
**DREKË PËR PJESËMARRËSIT NË EVENTIN KONFERENCË PËRMBYLLËSE**

## Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në zbatim të projektit "Drejt efikasitetit dhe integritetit më të mirë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë", mundësuar dhe mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës Amerikane në Tiranë, shpall kërkesën për ofertë për një subjekt tregtar i cili ofron me qera një salle konferencash bashkë me pajisjet mbështetëse (mikrofonë statikë dhe 4 mikrofonë të lëvizshëm/sistem audio/monitor vizual për shfaqjen e prezantimeve në poËerpoin, internet ëifi, pajisjet për përkthim simultan, sistem për realizimin e eventit në format online hibrid<sup>1</sup> etj.) për organizimin e një konference përmbyllëse në Tiranë midis datave 6 dhe 9 Dhjetor 2021.<sup>2</sup>

Organizimi i eventit duhet të bëhet i mundur në përputhje me masat për parandalimin e përhapjes së Covid-19 nga ana e autoriteteve shtetërore.

Gjithashtu, subjekti tregtar duhet të ofrojë coffee break dhe drekë për rreth 50 pjesëmarrës.

### Oferta financiare duhet të përfshijë:

- Ofertën financiare për qeranë e sallës (duke identifikuar dhe kostot respektive për mjetet facilituese të sipërpërmendura të përfshira në këtë vlerë, si dhe duke përcaktuar kapacitetin e sallës)
- Oferta financiare për qeranë e sallës duhet të jetë e përcaktuar për të dyja opsionet: gjysëm dite dhe ditë të plotë.
- Ofertën financiare për pajisjet e përkthimit simultan
- Ofertën financiare për coffee break.
- Ofertën financiare për drekë.

**KShH fton të gjitha subjektet e interesuara që të dërgojnë në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al) ose postare, deri në datën 28.10.2021, dokumentacionin e mëposhtëm:**

---

<sup>1</sup> Ky sistem duhet të përfshijë realizimin e eventit fizikisht dhe nëpërmjet platformës zoom.

<sup>2</sup> Eventi do të realizohet vetëm në 1 ditë.

*\*Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të zbatimit të nismës "Drejt efikasitetit dhe integritetit më të mirë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë", i cili mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës Amerikane në Tiranë. "*



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

1. Ofertën financiare në Dollarë (me TVSH të përfshirë) \*<sup>3</sup>
2. Foto të sallës në të cilën do të realizohet eventi
3. Listë e pajisjeve facilituese të cilat përfshihen në çmimin e qerasë
4. Çertifikatën e regjistrimit (nqs ofertuesi është kompani/subjekt tregtar)
5. Oferta duhet të jetë e firmosur dhe e vulosur

---

<sup>3</sup> \*Subjektet që nuk i nënshtrohen TVSH ta deklarojnë këtë status.

*\*Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të zbatimit të nismës "Drejt efikasitetit dhe integritetit më të mirë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë", i cili mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës Amerikane në Tiranë. "*